



KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr.16, datë 30.04.2020

**Për miratimin e “Rregullores për Kartën e Auditimit të brendshëm  
në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”**

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja “a” dhe shkronja “dh”, të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014 datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar; të nenit 14, shkronja “b”, të nenit 12, shkronja “c” të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të nenit 7 pika 4 dhe pika 6, të nenit 18 të Statutit të Agjencisë, të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Audituesit të Brendshëm të Agjencisë, Këshilli Drejtues,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë “Rregulloren për Kartën e Auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Audituesi i Brendshëm dhe subjektet e kësaj rregulloreje për zbatimin e saj.
3. Vendimi i Këshillit Drejtues nr.117 datë 23.05.2005 “Për rregulloren për funksionimin e auditit të brendshëm të ASD” shfuqizohet.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

**Sekretar**

Donald Duraj

**Kryetar**